**UDHËZIM**
**Nr. 123, datë 23.2.2018**

# PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË PUNËVE TË BRENDSHME NR. 277, DATË 29.5.2015 "PËR PROCEDURAT, DOKUMENTACIONIN DHE AFATET E SHQYRTIMIT PËR PAJISJEN ME AUTORIZIM PËR ARMË TË SUBJEKTEVE JURIDIKË E FIZIKË, FORMATIN E REGJISTRIT PËR ARMËT, PËR SUBJEKTIN E LICENCUAR PËR VEPRIMTARITË ME ARMËT, PËR RREGULLAT, PROCEDURAT DHE FORMULARIN QË PLOTËSOHET NË KOHËN E REALIZIMIT TË QITJES EKSPERIMENTALE DHE ADMINISTRIMIN E GËZHOJËS NË NJË BANKË TË DHËNASH"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 2 të nenit 11, të germës "dh" të nenit 22 dhe të pikës 2 të nenit 34 të ligjit nr. 74/2014 "Për armët",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 277, datë 29.5.2015 të Ministrit të Punëve të Brendshme, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun e I-rë, "PËR PROCEDURAT, DOKUMENTACIONIN DHE AFATET E SHQYRTIMIT PËR PAJISJEN ME AUTO-RIZIM PËR ARMË TË SUBJEKTEVE JURIDIKË E FIZIKË", bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1.1 Në pikën 2 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1.1.1 Në germën "d", fjalët "drejtori i Policisë" zëvendësohen me fjalët "Drejtori i Përgjithshëm i Policisë".

1.1.2 Pas germës "f" shtohet germa "g" me këtë përmbajtje:

"g) Afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë e fizikë janë:

i) Afati i lëshimit të autorizimit për blerje arme zjarri, është 90 ditë nga dita e aplikimit.

ii) Afati i lëshimit të autorizimit për blerje arme gjahu/të ftohta, është 30 ditë, nga dita e aplikimit.

iii) Autorizimi për mbajtje arme zjarri, gjahu/të ftohtë lëshohet brenda 15 ditëve nga dorëzimi i dokumenteve të blerjes së armës."

1.2 Pas pikës 13 shtohet pika 13/1 me këtë përmbajtje:

"13/1 Shtetasi i pajisur me autorizim për mbajtje armë gjahu, në rastet kur kërkon të blejë një armë gjahu tjetër, paraqet në njësinë vendore të policisë të gjithë dokumentet e përcaktuara në pikën 13, të këtij udhëzimi, me përjashtim të dëshmisë për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës."

1.3 Në pikën 15 pas germës "c" shtohet germa "ç", me këtë përmbajtje:

"ç) fotokopje të autorizimit të mbajtjes së armës të kategorisë "B"".

1.4 Në pikën 17 pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"ç) fotokopje të letërnjoftimit".

1.5 Pika 18 ndryshohet si më poshtë vijon:

"18. Shtetasit e punësuar në struktura shtetërore të armatosura, që kanë të drejtë të mbajnë armë, në rastet kur kërkojnë të pajisen me autorizim për blerje arme të kategorive "B1", "C" dhe "D3", dorëzojnë në zyrat e shërbimit të qytetarëve, dokumentet e mëposhtme:

a) fotokopje të letërnjoftimit;

b) vërtetimin nga institucioni ku ai kryen detyrën;

c) formular aplikimi dhe vetëdeklarimi për autorizim;

d) fotografi, 2 copë;

e) mandat pagesën e tarifës."

1.6 Pika 22 ndryshohet si më poshtë vijon:

"22. Formatet e mëposhtme të autori-zimeve për blerje arme, i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij:

a) Autorizim për blerje arme zjarri-model 1;

b) Autorizim për blerje arme gjahu/të ftohta - model 2."

1.7 Pika 23 ndryshohet si më poshtë vijon:

"23. Formatet e mëposhtme të autorizimeve për mbajtje arme dhe autorizimeve provizore, i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij:

a) Autorizime për mbajtje arme zjarri;

i) Autorizim për mbajtje arme zjarri në vendbanim - model 3;

ii) Autorizim për mbajtje arme zjarri i posaçëm - model 4;.

iii) Autorizim për mbajtje arme gjahu/ sportive - model 5;

iv) Autorizim për mbajtje arme të ftohtë - model 6;

v) Autorizim për mbajtje arme për koleksion - model 7.

b) Autorizime provizore për armë;

i) Autorizim provizor për nxjerrjen e armës nga vendbanimi - model 8;

ii) Autorizim provizor për shitje arme një shtetasi të huaj - model 9;

iii) Autorizim provizor për mbajtjen e armës nga misionet e huaja - model 10;

iv) Autorizim provizor hyrje-dalje/transit të armëve të gjahut/sportive - model 11."

1.8 Pika 24 ndryshohet si më poshtë vijon:

"24. Formatet e mëposhtme të autorizimeve për mbajtje arme zjarri, për punonjësit e shërbimit të SHPSF-së, janë sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

a) Autorizim për mbajtje arme zjarri në shërbim për punonjës të SHPSF-së - model 12;

b) Autorizim për mbajtje arme zjarri në shërbim dhe në lëvizje për punonjës të SHPSF-së - model 13."

1.9 Pika 27 ndryshohet si më poshtë vijon:

"27. Subjektet juridikë e fizikë që, sipas ligjit, u lind e drejta për t'u pajisur me autorizim për mbajtje arme të kategorisë B1, lejohen të mbajnë armë të shkurtër me kalibër 5.5 mm deri 9 mm, me vjaska dhe deri në 50 copë fishekë për armë".

1.10 Pika 28 ndryshohet si më poshtë vijon:

"28. Subjektit të licencuar për poligon qitjeje i lejohet të mbajë:

a) armë të shkurtër të kalibrit 5.5 mm deri në 9 mm, kategoria B1;

b) armë të gjatë kalibri 5.5 mm deri në 9 mm me vjaska, kategoria B4;

c) armë të gjatë pa vjaska, kategoria B4;

ç) armë pneumatike deri në 7.5 J, me saçma;

d) subjekti i licencuar për poligon qitje e blen municionin me licencë, ndërsa federata sportive me autorizim të policisë vendore;

e) municioni për poligonet dhe federatat e sporteve të jetë pa kufizim dhe sipas kapacitetit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

1.11 Pika 29 ndryshohet si më poshtë vijon:

"29. Subjektet që plotësojnë kriteret ligjore, u lejohet të mbajnë armë gjahu dhe sportive, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) shtetasit pajisen me armë gjahu pa vjaska dhe armë të ftohta, me autorizim të lëshuar nga policia vendore;

b) federata e qitjes sportive pajiset me armë të kategorisë "C", me autorizim të lëshuar nga policia vendore;

c) armët pneumatike me ajër me saçma, me energji nën 7.5 J dhe armët e zjarrit për sinjalizim me dritë dhe ato me zë, blihen dhe mbahen nga personat fizikë dhe juridikë pa autorizim, me detyrimin për t'i regjistruar në komisariatin e policisë, brenda 5 ditëve nga data e blerjes."

2. Në kreun II, "FORMATI I REGJISTRIT PËR ARMËT PËR SUBJEKTIN E LICEN-CUAR PËR VEPRIMTARI ME ARMËT", pika 36 ndryshohet si më poshtë vijon:

a) "Personi fizik, i cili ka në pronësi armë gjahu të kategorisë "C", lejohet t'ia shesë një shtetasi të huaj, me autorizim të veçantë të lëshuar nga drejtoria vendore e policisë. Autorizimi për shitjen e armës është sipas formatit përkatës, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

b) Shtetasi i huaj paraqet dokumentin e përkthyer dhe të noterizuar, që e autorizon të blejë armë.

c) Personat fizikë që bëjnë shitjen e armës, paraqesin në organin përgjegjës të policisë vendore aktin noterial dhe armën e gjahut fizikisht për veprimet e heqjes së armës nga regjistri.

d) Shtetasi i huaj që ka blerë armën e gjahut paraqet në pikën e kalimit kufitar autorizimin e lëshuar nga policia vendore dhe dokumentet shoqëruese.

e) Veprimet për ndryshimin e pronësisë së armës kryhen në zyrat noteriale."

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohet Policia e Shtetit, subjektet fizike dhe juridike që kryejnë veprimtari të lejuara me armët.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
**Fatmir Xhafaj**

Model 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Nr. _____ Prot. _____, më ___.___.20__

# A U T O R I Z I M

**( Për blerje arme zjarri )**

Në zbatim të nenit 24, të Ligjit Nr. 74/2014 "Për armët", Udhëzimit të MPB nr. 277, datë 29.05.2015 "Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë e fizikë, formatin e regjistrit për armët, për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhojës në një bankë të dhënash", Urdhrit të MPB Nr. 156, datë 01.04.2015 "Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtaritë e lejuara me armë", si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Policisë së Shtetit **Nr.____, datë ___. ___. 20__.**

**Autorizohet** personi fizik/juridik _____, i datëlindjes _____ lindur në _____ dhe banues në Njësia Administrative _____, rruga _____, _____, identifikuar me ID _____, për të blerë armë të kategorisë "B" pranë subjekteve të licencuara nga Drejtoria e Policisë së Shtetit "Për import/eksport dhe tregtim për armët e kategorive "B1", "B4", "C" dhe "D", si vijon:

- ✓ _____ armë të shkurtër/gjatë të kalibrit _____, me/pa vjaska, të kategorisë "B1","B4".
- ✓ Municioni për armën e shkurtër/gjatë _____ fishekë për armë.

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës, të bëjë regjistrimin në Njësinë Vendore të Policisë.

Njësia e regjistrimit të armëve Komisariati i Policisë _____, DVP _____.

Ky autorizim është i vlefshëm 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

**DREJTORI**

_____
Vula

Model 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Drejtoria Vendore e Policisë _____

Nr. _____ Prot. _____, më ___.___.20__

# A U T O R I Z I M

**( Për blerje arme të kategorisë "C"/ "D3" )**

Në zbatim të nenit 24, të Ligjit Nr. 74/2014 "Për armët", Udhëzimit të MPB nr. 277, datë 29.05.2015 "Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë e fizikë, formatin e regjistrit për armët, për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhojës në një bankë të dhënash", Urdhrit të MPB Nr. 156, datë 01.04.2015 "Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtar të lejuara me armë", si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë Vendore të Policisë _____, **Nr.____, datë ___.___.20__.**

**Autorizohet** personi fizik _____, i datëlindjes ___.___.__ , lindur në _____ dhe banues në Njësia Administrative _____, rruga _____, _____, identifikuar me ID _____, të blejë armë gjahu _____ / armë të ftohte_____ brenda dhe jashtë vendit.

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës, të bëjë regjistrimin në Njësinë Vendore të Policisë ku ka vendbanimin.

Njësia e regjistrimit të armëve Komisariati i Policisë _____, DVP _____.

Ky autorizim është i vlefshëm 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

**DREJTORI**

_____

Vula

*Model 3*



Model 3

Model 4


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Nr i Regjistrit
AUTORIZIM PËR
MBAJTJE ARMË ZJARRI
(I POSAÇËM)
Mbiemri
Emri
Atësia
Nr. personal
Data e Lindjes
Adresa
AL
TIPI
Marka
Modeli
Kalibri
Nr. Serial
Data e Lëshimit
Data e Skadimit
Autorizimi është i vlefshëm për
mbajtje armë në vendbanim dhe
në lëvizje.

Model 5


REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Pergjithshme e Policise
Nr i Regjistrit
AUTORIZIM PERMBAJTJE ARME GJAHU/SPORTIVE
Mbiemri
Emri
Atësia
Nr. personal
Data e Lindjes
Adresa
AL


TIPI
Marka
Modeli
Kalibri
Nr. Serial
Data e Lëshimit
Data e Skadimit
Autorizimi është i vlefshëm jashtë vendbanimit I shoqeruar me lejen e gjuetisë ose lejen e policisë

Model 6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Drejtoria Vendore e Policisë _____

Nr. _____ Prot. _____, më ___.___.20__

# A U T O R I Z I M

**( Për mbajtje arme të ftohtë kategoria "D3" )**

Në zbatim të nenit ___, të Ligjit Nr. 74/2014 "Për armët", Udhëzimit të MPB nr. 277, datë 29.05.2015 "Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë e fizikë, formatin e regjistrit për armët, për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhojës në një bankë të dhënash", Urdhrit të MPB Nr. 156, datë 01.04.2015 " Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtar të lejuara me armë", si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë Vendore të Policisë _____, **Nr._____, datë ___.___.20__.**

**Autorizohet** personi fizik _____, i datëlindjes ___.___._, lindur në _____ dhe banues në Njësia Administrative _____, rruga _____, _____, identifikuar me ID _____, të mbajë arme të ftohtë të kategorisë D3.

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës, të bëjë regjistrimin në Njësinë Vendore të Policisë ku ka vendbanimin.

Ky autorizim është i vlefshëm 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

**DREJTORI**

_____

Vula

Model 7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Nr. _____ Prot. _____, më ___.___.20__

# A U T O R I Z I M

**( Për koleksionim armësh )**

Në zbatim të nenit 12, germa "ë", të nenit 24, pika 1, germa "d", të nenit 26, pika 1, germa "a" dhe të nenit 32, të Ligjit nr. 74/2014 "Për armët", VKM nr. 96, datë 04.02.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të deklarimit, ruajtjes regjistrimit dhe paaftësimit për armët e koleksionit", VKM nr. 275, datë 01.04.2015 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e sigurisë të armëve", Udhëzimit të MPB nr. 277, datë 29.05.2015 "Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë e fizikë, formatin e regjistrit për armët, për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhojës në një bankë të dhënash", Urdhrit të MPB nr. 156, datë 01.04.2015 "Për procedurat e komisionit për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë" si dhe Vendimit të Komisionit **Nr.____, datë ___.___.20__** për dhënie/revokim të autorizimit për koleksionim armësh",

Autorizohet për koleksionim armësh subjekti fizik/muzeu _____ **në emër të shtetasit_____,i datëlindjes_____.____.20___, dhe banues në** Njësia Administrative _____, Rruga "_____", identifikuar me ID _____, në adresë të vendit të koleksionimit të armëve:

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës, të bëjë regjistrimin në Njësinë Vendore të Policisë ku ka vendbanimin.

Ky autorizim është me afat të përhershëm.

**DREJTORI**

_____
Vula

Model 8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Drejtoria Vendore e Policisë _____
Komisariati i Policisë _____

*Adresa:* ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ... ...

Nr. _____ Prot. _____, më ___.___.20__

**AUTORIZIM PROVIZOR**

*(DITOR)*

**Për**
**nxjerrjen e armës nga vendbanimi**

Në zbatim të germave "ç"/"ç", të nenit 37, të ligjit 74/2014 "Për armët'', shtetasi _____, i datëlindjes ___.___.__, lindur në _____ dhe banues në _____, juridiksion i Komisariatit të Policisë _____, i pajisur me autorizim mbajtje arme: Tip _____, modeli _____, kalibri _____, me numër serie _____,

Autorizohet të nxjerrë armën nga vendbanimi për qitje sportive/ shërbime e riparime teknike pranë subjektit _____ të licencuar "Për Poligon Civil Qitje"/i licencuar për shërbime teknike , me adresë _____.

Ky autorizim është i vlefshëm për datën ___.___.20__, dhe lëshohet jo më shumë se një ditë në muaj.

**SHEFI I KOMISARIATIT**

_____

Vula

Model 9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Drejtoria Vendore e Policisë _____

Nr. _____ Prot. _____, më ___.___.20__

**AUTORIZIM PROVIZOR**

**( Për shitjen e armës një shtetasi të huaj )**

Nr._____, datë ___.___.20__

Në bazë të pikës 36 dhe 37, të kreut II, të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 277, date 29.05.2015, "Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë e fizikë, formatin e regjistrit për armët, për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhojës në një bankë të dhënash",
Autorizohet shtetasi/subjekti _____ i pajisur me Autorizim për mbajtje arme gjahu/licencuar për Import /eksport dhe tregtim për armët e kategorisë B1, B4, C dhe D, nga Policia Vendore/Drejtori i Policisë së Shtetit nr._____, datë ___.___. 20___, të shesë armën e gjahut tip _____, modeli _____, kalibri _____, me numër serie _____, shtetasit _____, me shtetësi _____, me dokument ID _____, në përputhje me dokumentacionin ligjor nga vendi i origjinës.

Pasi shtetasi paraqiti dokumentin noterial në njësinë vendore të policisë, u bë çregjistrimi i armatimit nga regjistrat e policisë vendore.

Shtetasi _____ lejohet të dalë nga Pika e Kalimit Kufitar me armën e gjahut të cituar më sipër.

**DREJTORI**

(_____)

Vula

Model 10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Nr. _____ Prot. _____, më ___.___.20__

**AUTORIZIM PROVIZOR**

**( Për mbajtje arme personale )**

foto

Në zbatim të nenit 40, të ligjit 74/2014 "Për armët", dhe pikës 19, të Udhëzimit të MPB nr. 277, datë 29.05.2015 "Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë e fizikë, formatin e regjistrit për armët, për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhojës në një bankë të dhënash",

**Z./Grada** _____

Punonjës i Misionit _____, autorizohet të mbajë armë personale, model _____, kalibri _____, me nr. _____, me _____ copë fishekë.

Autorizimi është i vlefshëm me pasaportë personale/dokument, nga data ___.___.20__ deri më datë ___.___.20__.

**DREJTORI**

_____

Vula

Model 11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Nr. _____ Prot. _____, më ___.___.20__

**AUTORIZIM PROVIZOR**

**( Për hyrje-daljen/transit të armëve të gjahut dhe sportive )**

Në zbatim të shkronjës "d", të nenit 40, të ligjit nr. 74/2014 "Për armët" dhe pikës 20 dhe 21 të Udhëzimit të MPB nr. 277, datë 29.05.2015, "Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë e fizikë, formatin e regjistrit për armët, për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhojës në një bankë të dhënash",

**Autorizohet** personi fizik/juridik/Federata e Qitjes Sportive _____, për lejimin e hyrje-daljes/transit të armëve të gjahut/sportive në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datat ___.___.20__ deri ___.___.20__, hyrje nga Pika e Kalimit Kufitar _____, dalje nga Pika e Kalimit Kufitar _____, me të dhënat si më poshtë:

Armët e gjahut/sportive:

1. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri ___ mm dhe numër serie _____;
2. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri ___ mm dhe numër serie _____;
3. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri ___ mm dhe numër serie _____;
4. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri ___ mm dhe numër serie _____;
5. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri ___ mm dhe numër serie _____;
6. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri ___ mm dhe numër serie _____;

**DREJTORI**

_____

Vula

Model 12

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Drejtoria Vendore e Policisë _____

Nr. _____ Prot. _____, më ___. ___. 20__

# A U T O R I Z I M

**(Për Mbajtje arme në shërbim për punonjësin e SHPSF-së)**

Në bazë të vendimit nr.____, datë ___.___.20__, të Komisioni të Shqyrtimit të Kërkesave për dhënie/revokim të mbajtjes së armës në Drejtorinë Vendore të Policisë _____,

**V E N D O S I :**

Miratimin e Autorizimit për mbajtje armë zjarri në shërbim për punonjësit e shërbimit:

Emër _____

Atësia _____

Mbiemri _____

Datëlindja _____

ID _____

Nr. Certifikatës _____

Autorizimi për mbajtje arme zjarri në shërbim është i vlefshëm gjatë kohës së punës vetëm në ambientet e punës dhe shërbimit.

Autorizimi është i vlefshëm 5 vjet, nga afati i lëshimit të tij, me të drejtë ripërtëritje.

**DREJTORI**

(_____)

Vula

Model 13

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Drejtoria Vendore e Policisë _____

Nr. _____ Prot. _____, më ___. ___. 20__

# A U T O R I Z I M

**Për**
**Mbajtje arme në shërbim dhe në lëvizje për Drejtuesin Teknik/Punonjësin e SHPSF-së**
**(Truprojë)**

Në bazë të vendimit nr.____, datë ___.___.20__, të Komisioni të Shqyrtimit të Kërkesave për dhënie/revokim të mbajtjes së armës në Drejtorinë Vendore të Policisë _____,

## V E N D O S I :

Miratimin e Autorizimit për mbajtje armë zjarri në shërbim dhe në lëvizje për Drejtuesin Teknik/Punonjësin e SHPSF-së.

Emër _____

Atësia _____

Mbiemri _____

Datëlindja _____

ID _____

Nr. Certifikatës _____

Autorizimi për mbajtje arme zjarri në shërbim dhe në lëvizje është i vlefshëm gjatë kohës së punës dhe shërbimit.

Autorizimi është i vlefshëm 5 vjet, nga afati i lëshimit të tij, me të drejtë ripërtëritje.

**DREJTORI**

(_____)

*Vula*